



Nr.25/2026
Datë: 26.01.2026

Komisioni i Ankesave i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", në përbërje: znj. Fari Marmullaku, kryesuese, z. Tefik Mehmeti dhe z. Durim Hasaj, anëtarë, në mbështetje të nenit 88 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe në përputhje me nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr këtë::

V E N D I M

1. Anullohet procedura e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Bibliotekës Digjitale".
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni, pas shqyrtimit të ankesës dhe analizimit të procedurës së zhvillimit të konkursit, konstatoi se gjatë publikimit të kriterëve të konkursit kanë ndodhur gabime teknike, meqë kriteret janë publikuar në mënyrë të ndryshme në platformën SIMBNJ, krahasuar me konkursin e publikuar në faqen zyrtare të Bibliotekës.

Për rrjedhojë, anëtarët e Komisionit vendosin për anulimin e procedurës së konkursit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Bibliotekës Digjitale", rikthimin e procedurës në fazën fillestare (pika zero), si dhe rishpalljen e konkursit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Komisioni për Ankesa i BKK-së "Pjetër Bogdani"

Znj. Fari Marmullaku- Kryesuese e Komisionit _____

Z.Tefik Mehmeti- Anëtar i Komisionit _____

Z.Durim Hasaj – Anëtar i Komisionit _____